



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

NJOFTIM

Për fillimin e procedurës së konkurimit për emërimin në pozicionin e punës sekretare pranë prokurorëve, në prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Bazuar në nenin 42 gërma “a”, 76 e vijues , të Ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm, nr.54, datë, 18.04.2023 “Për strukturën organike të Prokurorive të Shkallës Parë, dhe Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave dhe pozicioneve vakante të krijuara ;

Kërkohet të punësohet 1 (një) punonjës në pozicionin “sekretar pranë prokurorëve” në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Kërkesat e përgjithshme për kandidatët

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore, që nuk është shuar.

Kërkesat e vecanta për kandidatët

- të ketë mbaruar studimet e larta në Drejtësi,
- të njohë mirë kompjuterin, vërtetuar me dokumentin përkatës
- të ketë njohuri të mira gjuhësore e drejtshkrimi
- të ketë njohuri të mira minimalisht të një gjuhe të huaj,
- të ketë përvojë profesionale minimalisht për një periudhë një vjeçare
- të prezantojë etikë, qytetari dhe nivel performance të denjë për institucionet shtetërore dhe të pranojë e realizojë testimin bazë që përfshin komunikim të lirë me komisionin

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Të gjithë kandidatët si më sipër duhet të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:

- a. Jetëshkrimin;
- b. Kërkesë për aplikim
- c. Fotokopje të diplomës;
- d. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë përvojën në punë);
- e. Çdo dokumentacion që vërteton eksperiencën të tjera punësimi brenda ose jashtë vendit, të lëshuar nga punëdhënësi;
- f. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- g. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- h. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentave është data : 07.10.2024

Konkurrimi për vendin e punës sekretare pranë prokurorëve, do të bazohet në:

1. Ligjin nr.97/2016, “Per organizimin e funksionimit e Prokurorisë së Përgjithshme;
2. Ligji nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. në Republikën e Shqipërisë”
3. Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar,
4. Kodi i Procedurës Penale.
5. Ligjin nr.7961 datë.12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Konkurrimi do të zhvillohet në dy faza:

I. Faza e parë:

- Verifikimi paraprak i kandidatëve për plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe atyre të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim

II. Faza e dytë përbëhet nga vlerësimi i kandidatëve që përfshin:

- Vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore
- Vlerësimi me shkrim.
- Intervista e strukturuar me gojë.

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët do të bëhet nëpërmjet adresave të email-, me mesazhe në numrin e celularit të kandidatit, në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe ambjenteve të Prokurorisë së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Për çdo informacion më të hollësishëm gjithë të interesuarit të paraqiten në Prokurorinë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

PROKURORIA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Tiranë datë 11.09.2024